



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-070**

**PËR DHËNIEN E DEKORATAVE NGA PRESIDENTI I  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR DHËNIEN E DEKORATAVE NGA PRESIDENTI I  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi ligjor i dhënies dhe revokimit të dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, për qytetarët e Republikës së Kosovës, personat juridik, qytetarët e huaj dhe organizatat e ndryshme që shquhen për merita të veçanta ndaj Republikës së Kosovës dhe interesave të saj.

## **Neni 2 Fushëveprimi**

Ky ligj rregullon procedurat dhe kriteret për dhënien dhe revokimin e Dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe të drejtat dhe detyrat e të dekoruarve.

## **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Dekorata** - urdhrat, medaljet, çmimet, mirënjohjet dhe titujt e nderit që i jep Presidenti i Republikës së Kosovës.

1.2. **Revokim i dekoratës** - heqja e së drejtës dikujt, për bartjen e Dekoratës së dhënë nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

## **KREU II DEKORATAT**

### **Neni 4 Dhënia e dekoratave**

1. Dekoratat mund tu jepen qytetarëve të Republikës së Kosovës, personaliteteve të njohura publike, personave juridikë dhe subjekteve tjera.

2. Dekoratat mund tu jepen qytetarëve edhe pas vdekjes.

3. Dekoratat mund tu jepen shtetasve të huaj, personaliteteve të njohura botërore dhe organizatave ndërkombëtare.

4. E njëjta dekoratë nuk mund t'i jepet dy herë të njëjtit person.

5. Dhënia e dekoratave mund të shoqërohet me një shpërblim në të holla, sipas kriterëve që do të caktojë Presidenti i Republikës së Kosovës.

### **Neni 5 Llojet e dekoratave**

Presidenti i Republikës së Kosovës përcakton llojet e Dekoratave me rregullore të veçantë.

**KREU III**  
**PROCEDURAT DHE KRITERET E DHËNIES SË DEKORATAVE NGA**  
**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Neni 6**  
**Dhënia e dekorata me vetiniciativë**

1. Presidenti i Republikës me vetiniciativë mund të dekoroj:
  - 1.1. Kryetarin e Kuvendit;
  - 1.2. Kryeministrin;
  - 1.3. Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese;
  - 1.4. Kryetarin e Gjykatës Supreme;
  - 1.5. Kryeprokurorin e Republikës së Kosovës;
  - 1.6. Ministrat e Qeverisë të Republikës së Kosovës;
  - 1.7. Komandantin e Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës;
  - 1.8. Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë;
  - 1.9. Personalitetet nga fusha të ndryshme të jetës, shoqëria civile dhe organizata tjera;
  - 1.10. Shtetasit e huaj me funksione të larta në vendin e tyre; dhe
  - 1.11. Shtetasit e huaj që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për Republikën e Kosovës.

**Neni 7**  
**Dhënia e propozimit për dekorata**

1. Presidentit të Republikës së Kosovës, propozim për dekorata mund t'i paraqesin:
  - 1.1. Kryetari i Kuvendit;
  - 1.2. Kryeministri;
  - 1.3. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
  - 1.4. Deputeti i Kuvendit të Kosovës;

- 1.5. Kryetari i Gjykatës Supreme;
  - 1.6. Kryeprokurori i Republikës së Kosovës;
  - 1.7. Ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
  - 1.8. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës;
  - 1.9. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë;
  - 1.10. Kryetari i Komunës;
  - 1.11. Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës;
  - 1.12. Rektorët e Universiteteve publike të Kosovës;
  - 1.13. Personi me reputacion publik dhe organizata të tjera.
2. Shtetasit e huaj që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për Republikën e Kosovës.

## **Neni 8**

### **Kriteret që duhet t'i plotësojë propozimi për dekoratë**

1. Propozimi për dekoratë është i plotë nëse i plotëson kriteret e mëposhtme:
  - 1.1. dërgohet dy (2) muaj para veprimtarisë, përvjetorit apo ngjarjeve historike që i përket personit apo institucionit;
  - 1.2. nënshkruhet nga titullari i institucionit që ka të drejtën e propozimit;
  - 1.3 shoqërohet me arsyetimin përkatës ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta të të propozuarit me biografi të personit të propozuar.
2. Propozimet për Dekoratë të shtetasit të huaj që ndodhet në shërbim të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës bëhen nga institucioni ku është i punësuar.
3. Propozimin për dekorim të shtetasve të Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit dhe personalitete të huaja që kanë dhënë apo japin ndihmë për Republikën e Kosovës dhe imazhin e saj e bën Kryeministri dhe Ministri i jashtëm.
4. Propozimit për dekoratë të pjesëtarit të policisë përveç arsyetimit të propozuesit duhet bashkangjitur edhe mendimin e Ministrisë përkatëse për punë të brendshme.
5. Propozimit për dekoratë të ushtarakut përveç arsyetimit të propozuesit duhet bashkangjitur edhe mendimin e Ministrisë përkatëse për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

**Neni 9**  
**Komisioni vlerësues për dhënien e dekoratave**

1. Komisioni vlerësues për Dekorata përbëhet nga personalitete eminente që emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
2. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, prej të cilëve së paku njëri anëtar duhet të jetë nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë.
3. Anëtari/ët nga radhët e komuniteteve jo-shumicë propozohen nga Këshilli Konsultativ për Komunitete.
4. Komisioni i analizon propozimet, arsyetimet për dhënien e Dekoratës.
5. Arsyetimet për revokimin e Dekoratës dhe së bashku me sugjerimin e tyre për propozimin ia dërgojnë Presidentit të Republikës së Kosovës.
6. Presidenti i Republikës së Kosovës përcakton punën e Komisionit Vlerësues për Dekorata me një rregullore të veçantë.

**Neni 10**  
**Miratimi i propozimeve për dekorata**

1. Miratimi i propozimeve për dekorata është e drejtë e Presidentit të Republikës së Kosovës.
2. Presidenti vlerëson propozimin, e miraton ose nuk e miraton, vendos për të dhënë dekoratë tjetër nga ajo që është propozuar ose e riformulon arsyetimin.
3. Dhënia e dekoratave nga Presidenti publikohet në Gazetën Zyrtare dhe në ueb- faqen zyrtare të Presidentit të Kosovës.

**KREU IV**  
**DHËNIA E DEKORATAVE, TË DREJTAT DHE DETYRAT E TË DEKORUARVE**

**Neni 11**  
**Ceremonia e dhënies së Dekoratave**

1. Ceremonia e dhënies së dekoratës organizohet nga institucioni që ka propozuar dekorimin në bashkëpunim me Sekretarin e Zyrës së Presidentit, ku Dekoratën e jep Presidenti i Republikës, ose persona të deleguar personalisht nga Presidenti.

2. Në raste të veçanta, për personalitete me merita shumë të veçanta ceremonia e dekorimit organizohet në selinë e Presidentit, ku Presidenti i Republikës e jep vetë dekoratën.

3. Ceremonia e dhënies së Dekoratës jashtë shtetit organizohet nga Përfaqësia e diplomatike e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me propozuesin, ku Dekoratën e jep Presidenti, personi i deleguar apo përfaqësuesi më i lart diplomatik i Republikës së Kosovës në atë shtet.

4. Nëse i dekoruari nuk pranon ta merr Dekoratën atëherë vepohet sikurse Dekorata të mos ishte dhënë fare.

## **Neni 12**

### **Dhënia e Dekoratës pas vdekjes**

1. Dhënia e Dekoratës pas vdekjes së të dekoruarit i bëhet familjarëve të tij: bashkëshortit/tes, fëmijët, të adoptuarit, nipat/mbesat, prindërit, adoptuesit, vëllezërit dhe motrat e të dekoruarit.

2. Nëse i dekoruari nuk ka anëtar të familjes sipas paragrafit 1. të këtij neni dhënia e Dekoratës publikohet në Gazetën Zyrtare dhe në ueb-faqen zyrtare të Presidentit të Kosovës.

3. Me vendim të Presidentit, Dekorata jepet në muze që të ruhet si pasuri kulturore e vendit.

## **Neni 13**

### **Bartja e Dekoratave**

1. Dekoratën e bartë vetëm i dekoruari.

2. Dekoratat zakonisht barten gjatë kohës së festave shtetërore dhe në manifestime tjera shtetërore.

3. Bartësi i dekoratës që pa fajin e tij e ka humbur Dekoratën, apo Dekorata e tij është dëmtuar ka të drejtë të kërkoj kopjen e Dekoratës.

4. Bartësi i dekoratës gjatë kohës sa është në mbajtje të dënimit nuk ka të drejt ta bart Dekoratën.

5. Nëse bartësi i Dekoratës vdes dhe nuk ka pasardhës ligjor, Dekorata kthehet te Presidenti i cili me vendim e jep në muze që të ruhet si pasuri kulturore e vendit.

## **Neni 14**

### **Revokimi i Dekoratave**

1. Të dekoruarit, mund ti revokohet Dekorata nëse vepron në kundërshtim me rendin publik, moralin dhe kryen vepra tjera që e bëjnë të pa denjë për bartjen e Dekoratës.

2. Presidenti me vendim revokon Dekoratën për personin sipas paragrafit 1. të këtij neni.
3. Propozimin për revokimin e Dekoratës mund ta bëjë propozuesi për Dekoratë.
4. Presidenti mund ta revokoj Dekoratën me vet iniciativë.
5. Vendimi për revokimin e Dekoratës publikohet në Gazetën Zyrtare dhe në ueb-faqen zyrtare të Presidentit të Kosovës.

### **Neni 15 Zyrtari për Dekorata**

1. Zyrtari përkatës për dekorata në kuadër të Zyrës së Presidentit e mbështet Komisionin Vlerësues për Dekorata.
2. Zyrtari përkatës për Dekorata në kuadër të Zyrës së Presidentit mban evidencën për emrin dhe mbiemrin e personit të dekoruar, llojin e Dekoratës, propozuesin, arsyetimin dhe shënime tjera për dhënien e Dekoratës, gjithashtu mban evidencë edhe në rast të revokimit së Dekoratës.
3. Zyrtari përkatës për Dekorata në kuadër të Zyrës së Presidentit mban evidencën edhe për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë marr Dekorata nga shtetet tjera ose organizata ndërkombëtare.
4. Shtetasi i Republikës së Kosovës duhet ta njoftoj zyrtarin përkatës për Dekorata në kuadër të Zyrës së Presidentit nëse merr Dekoratë nga ndonjë shtet tjetër ose organizatë ndërkombëtare.

## **KREU V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 16 Sanksionet**

Punimi, shitja, bartja e sendeve tjera që imitojnë Dekoratat e Republikës së Kosovës është e ndaluar dhe sanksionohet me ligj.

**Neni 17**  
**Dekoratat e mëparshme**

Të dekoruarit që janë dekoruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë të drejtë t'i bartin Dekoratat e tyre, por revokimi i Dekoratave bëhet sipas këtij ligji.

**Neni 18**  
**Organi përgjegjës për nxjerrjen e akteve nënligjore**

Presidenti i Republikës së Kosovës nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji në afat prej nëntëdhjetë (90) ditëve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 19**  
**Dispozitat shfuqizuese**

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushojnë së vepruari të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj.

**Neni 20**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-070**  
**21 dhjetor 2011**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**